



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.10/ 12 prot.

Datë 01.02.2024

**V E N D I M**  
**Nr.125 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 74/2024, datë 19.01.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “*Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A*”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me NIPT J62426002Q dhe adresë “Autostrada Tiranë-Durrës”, km 8, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST Sh.A), me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës Km. 9.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 19.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.74/2024, ku vendosi:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

I.2. Me shkresën nr. 557/1 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 10/09 prot., datë 31.01.2024, autoriteti kontraktor, njofton, se ka zbatuar vendimin Nr. 74/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST, duke i bashkëngjitur shkresës, shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit sipas vendimmarrjes së KPP-së dhe sipas vendimit të KSHA-së së autoritetit kontraktor.

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 557/1 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 10/09 prot., datë 31.01.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr. 74/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST, duke i

bashkëngjitur shkresës shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit sipas vendimmarrjes së KPP-së dhe sipas vendimit të KSHA-së së autoritetit kontraktor.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin nr. 74/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 74/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, pasi ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), shtojcën me ndryshimet në dokumentet e tenderit, në përputhje me konstatimet e vendimit nr. 74/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-92229-12-27-2023, me objekt “*Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST Sh.A*”, me fond limit 3,000,000.00 (tre milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 02.11.2023, nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

